

URDHËRESË ADMINISTRATIVE 1999/1

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 1999/3, DATË 31 GUSHT 1999,
PËR THEMELIMIN E DOGANËS DHE
SHERBIMEVE TE TJERA LIDHUR ME TË NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/3 për themelimin e shërbimit doganor dhe shërbimeve të tjera lidhur me të në Kosovë

Nxjerr këtë Udhëzimin Administrativ:

Neni 1
DETYRIMET DOGANORE, AKCIZAT DHE TATIMI MBI SHITJEN

1.1 Detyrimet doganore

Tarifa ekzistuese dhe ligji i tarifave doganore, të bazuara në Sistemin e Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave, deri në një njoftim të ardhshëm do të zbatohen me ndryshimet që vijojnë:

1.1.1 Ndryshime në kolonën 4 të tarifës (Përqindja e tarifës doganore)

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/3, datë 31 gusht 1999, neni 1.1, përqindjet e mëposhtme zbatohen për mallrat e importit. Të gjitha mallrat e cfarëdo lloji të destinuara për Kosovën dhe që nuk i nënshtrohen kurrfarë ndalimi të importit sipas ligjeve në fuqi, i nënshtrohen tarifës doganore prej dhjetë për qind (10%) për një periudhë kalimtare, me përjashtim të mallrave të theksuara në Aneksin I për të cilat tarifa doganore është barazi me zero për qind (0%).

1.1.2 Ndryshime të tarifës në kolonën 5 (regjimi i eksportit) dhe kolonën 6 (regjimi i importit):

- (a)LB1:leja e nevojshme jepet nga autoriteti kompetent i UNMIK-ut
- (b)D:Shërbimi Doganor i UNMIK-ut nxjerr një certifikatë import/eksporti për të autorizuar importimin/eksportimin e mallrave
- (c)D1 or D2:kërkohet autorizim special nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut
- (d)D3 or D4:për t'u zëvendësuar nga D
- (e)KK, KV, LB3 and LB4:për t'u zëvendësuar nga LB.

1.1.3 Pezullohet menjëherë neni 3 i ligjit ekzistues të tarifës.

1.2 Akciza

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/3, datë 31 gusht 1999, neni 1.2, akciza ekzistuese pezullohet. Të gjitha mallrat e përfshira në Aneksin II bashkëngjitur këtu, që importohen dhe destinohen për Kosovë, i nënshtrohen akcizës, ashtu siç parashihet në këtë Aneks. Akcizat, për arsye administrative, mbliken në pikat e kalimit kufitar.

1.3 Tatimi mbi shitjen

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/3, datë 31 gusht 1999, nenet 1.3 dhe 1.4, vendoset si masë e përkohshme tatimi mbi shitjen në masën pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës së tatueshme të të gjitha mallrave të importuara që destinohen vetëm për Kosovë, me përjashtim të atyre që janë theksuar në Aneksin III të bashkëngjitur. Me qëllim të llogaritjes së tatimit mbi shitjen, vlera e të gjitha mallrave të importuara do të përbëhet nga vlera e përgjithshme doganore, duke përfshirë detyrimet doganore dhe akcizat.

1.4 Derdhja e të ardhurave

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/3, datë 31 gusht 1999, neni 3, të ardhurat që rrjedhin nga detyrimet doganore, akciza dhe tatimi mbi shitjen për mallrat e destinuara për Kosovë derdhen në buxhetin e Kosovës.

Neni 2

NËPUNËSIT DOGANORË DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME TA

2.1 Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/3, datë 31 gusht 1999, neni 4, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në Kosovë.

2.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mundet, sipas autorizimit me shkrim, t'ia jep drejtorit të përgjithshëm të Doganave të UNMIK –ut kompetencën për të emëruar drejtorin e Shërbimit Doganor të UNMIK -ut dhe sipas nevojës edhe nëpunës të tjerë doganorë. Këta nëpunës duhet t'i kryejnë detyrat e tyre nën autoritetin e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut.

2.3 Nëpunësit e doganës së UNMIK-ut gjatë ushtrimit të detyrave të tyre mbajnë uniformë të dallueshme të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut. Secili prej këtyre nëpunësve duhet të mbajë një dokument identifikimi të UNMIK-ut, që duhet të tregohet sa herë të kërkohet të dëshmohet identiteti.

2.4 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është i vetmi institucion i autorizuar në Kosove për të kryer funksionet e doganës dhe të shërbime të tjera që lidhen me të.

Neni 3

INSPEKTIMET SANITARE FITOPATOLOGJIKE DHE VETERINARE

3.1 Deri në një njoftim tjetër:

UNMIK-u cakton Ndërmarrjen "Kosova Control", Rr. "Dardania", BL. 9/a, nr.3/a, 38000 Prishtinë, si të vetmen ndërmarrje të autorizuar për kontrollin sanitar, fitopatologjik dhe veterinar. Ata duhet t'i kryejnë detyrat e tyre në përputhje me ligjet ekzistuese.

Inspektorët e "Kosova Control"-it duhet të jenë të pranishëm në pikat kufitare të Hanit të Elezit (Djeneral Jankovi?) dhe në Vërmicë (Vrbnica), shtatë ditë në javë, prej orës 8:00 deri në orën 20:00.

3.2 Inspektorët janë të autorizuar të vendosin nëse mallrat do të zhdoganohen ose jo, të marrin mostra për analiza ose t'i kthejnë mallrat. Inspektorët lëshojnë certifikatën e cila, bashkë me formularin e deklaratës doganore, dorëzohet në Shërbimin Doganor të UNMIK-ut.

Neni 4 INSTITUCIONI PËR KRYERJEN E ANALIZAVE

Deri në një njoftim tjetër UNMIK-u cakton "Kosova Control"-in, Rr. "Dardania", BL. 9/a, nr. 3/a, 38000 Prishtinë, si të vetmin institucion të autorizuar nga ana e UNMIK-ut për analizën e mostrave të marra nga ana e inspektorëve fitosanitarë ose veterinarë të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut.

Neni 5 PIKAT ZYRTARE TË KALIMIT KUFITAR

5.1 Në pajtim me Rregulloren nr.1999/3 të UNMIK-ut, datë 31 Gusht 1999, neni 5, PSSP cakton Hanin e Elezit (Djeneral Jankovic), Globoçicë (Globocica), Vërmicë (Vrbnica) dhe Qafën e Prushit (Cafa Prusit" si të vetmet pika ndërkombëtare të autorizuar të kalimit kufitar.

5.2 Hani i Elezit (Djeneral Jankovic), Globoëica (Globocica), Vërmica (Vrbnica) do të jenë të hapura për trafik gjatë gjithë vitit shtatë ditë në javë, 24 orë në ditë.

5.3 Për qëllime të Doganës:

- Prej datës 3 shtator 1999, Hani i Elezit (Djeneral Jankovic) do të jetë zyrtarisht i hapur dhe do të fillojë punën. Kjo pikë e kalimit kufitar do të jetë e hapur për trafik tregtar shtatë ditë në javë prej orës 8:00 deri në orën 20:00,.

- Prej datës 13 shtator 1999, "Vërmica (Vrbnica) do të jetë zyrtarisht e hapur dhe do të fillojë punën. Kjo pikë e kalimit kufitar do të jetë e hapur për trafik tregtar shtatë ditë në javë prej orës 8:00 deri në orën 20:00.

- Prej datës 20 shtator 1999, "Globoëica (Globocica) do të jetë zyrtarisht e hapur dhe do të fillojë punën. Deri në një njoftim tjetër, vetëm ndihmat humanitare dhe kamionët tregtarë që transportojnë gurë nga guroret në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, do të lejohen të kalojnë nëpër këtë pikë të kalimit kufitar. Kjo pikë e kalimit kufitar do të jetë e hapur për zhdoganim të trafikut tregtar shtatë ditë në javë prej orës:00 deri në orën 20:00.

Deri te një njoftim tjetër pika e kalimit kufitar Qafa e Prushit (Cafa Prusit) do të jetë e mbyllur.

Neni 6 PEZULLIMI I PËRKOHSHËM I REGJIMEVE DOGANORE

Deri te një njoftim tjetër, mallrat e importuara apo të eksportuara do të zhdoganohen në pikat kufitare të caktuara në nenin 5. Qarkullimi i mallit tranzit ose përmes Kosovës nuk do të lejohet deri te një njoftim tjetër. Procesi i zhdoganimit si për futjen edhe për daljen e mallrave, si edhe vendosja e mallit nën mbikëqyrje doganore, pezullohen.

Neni 7

REGJISTRIMI I IMPORTUESVE/EKSPORTUESVE DHE I AGJENTEVE DOGANORË

7.1 Importuesit/eksportuesit dhe agjentët doganorë duhet të regjistrohen në zyrën e Doganës së UNMIK-ut në Prishtinë. Regjistrimi mund të bëhet çdo ditë nga e hëna deri të premten, prej orës 8:00 deri 15:00, duke filluar nga data 31 gusht 1999. Shërbimi Doganor i UNMIK-ut bën regjistrimet në regjistrin doganor përkatës.

7.2 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut regjistron në regjistrin doganor, të dhënat mbi regjistrimet e mëparshme të të gjithë importuesve/eksportuesve dhe agjentëve doganorë në bazë të dokumenteve që ata i paraqesin.

7.3 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut regjistron kompanitë e reja në bazë të paraqitjes nga nëpunësi i autorizuar për të përfaqësuar kompaninë, dëshminë e identitetit, emrit e adresës së kompanisë. Çdo person që kërkon të regjistrohet si agjent doganor duhet t'i plotësojë kërkesat e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut për aftësinë profesionale të tij/saj. Kopjet e dokumenteve origjinale që dëshmojnë këtë aftësi profesionale duhet t'i dorëzohen Shërbimit Doganor të UNMIK-ut.

7.4 Importuesit/eksportuesit dhe të gjithë agjentët doganorë duhet të shënojnë numrin individual të regjistrimit të tyre në të gjitha faturat dhe deklaratimet doganore.

7.5 Si dëshmi për regjistrim, Zyra e Doganës në Prishtinë lëshon certifikata regjistrimi. Agjentët doganorë të regjistruar pajisen me një kartë shtesë identifikimi, e cila do t'u mundësojë atyre të jenë të pranishëm dhe të veprojnë në pikat e kalimit kufitar.

7.6 Përkohësisht importuesit/eksportuesit duhet të përdorin agjentët e regjistruar doganorë për procedurat e zhdoganimit në pikat e kalimit kufitar.

7.7 Të gjithë importuesit/eksportuesit apo agjentët doganorë duhet të paguajnë një taksë administrative prej 25 DM (marka gjermane) në Shërbimin Doganor të UNMIK-ut.

Neni 8

DERGESAT HUMANITARE

8.1 Organizatat humanitare duhet t'i plotësojnë këto kushte lidhur me zhdoganimin e dërgesave me ndihma humanitare:

- Regjistrimin në Zyrën Doganore në Prishtinë.
- Dëshminë me shkrim nga donatori për të vërtetuar përmbajtjen e dërgesës.
- Deklaratën se ato mallra nuk do të shiten në tregun lokal.

8.2 Vetëm dërgesat me ndihma humanitare të destinuara për Kosovë lejohen të kalojnë kufirin.

Neni 9

DERGESAT PËR KFOR-in

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut dhe Misioni i Asistencës Doganore në Kosovë (CAM-K) vendosin rregulla për dërgesat e KFOR-it të transportuara nga kontraktues privat. Këto rregulla nxirren pas negociatave me Shtabin e KFOR-it.

Neni 10 PAGESAT

10.1 Deri te një njoftim tjetër, UNMIK-u cakton Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) me adresë në rrugën: “19 Nëntori” nr. 33 në Prishtinë si të vetmen arkë qendrore të pranuar për depozitimin e të ardhurave në pajtim me Rregulloren nr.1999/3 të datës 31 gusht 1999. UNMIK-u emëron një zyrtar të përshtatshëm, të cilit i jepet përgjegjësia për marrjen e këtyre të ardhurave. Të ardhurat e mbledhura transferohen në buxhetin e Kosovës.

10.2 Pagesat për detyrimet doganore, akcizat si dhe tatimi mbi shitjen për mallrat e importuara kryhen në BPK para importimit të tyre. Në rast të anulimit të urdhresës për importim, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave duhet t’i kthejë gjithë detyrimet doganore dhe tatimore të parapaguara nga blerësi që kishte planifikuar importin, në bazë të paraqitjes së dokumenteve përkatëse.

10.3 Pagesat e kryera me para në dorë për importet tregtare në pikat e kalimit kufitar do t’i nënshtrohen një tarife shtesë prej (5%) mbi detyrimin doganor, akcizën dhe tatimin mbi shitjen e llogaritur.

10.4 Orari i punës së BPK-së duhet të korrespondojë me orarin e punës së doganës në pikat e kalimit kufitar për zhdoganimin e trafikut tregtar të specifikuar në neni 5 më sipër, përveç të dielave.

Neni 11 VALUTA E MIRATUAR PER PAGESË

Detyrimet doganore, akcizat si dhe tatimqarkullimi duhet të paguhen me marka gjermane. Personi që dëshiron të paguajë detyrimin doganor dhe akcizën me dinarë, mund ta bëjë këtë në bazë të kursit të këmbimit në ditën e pagesës, plus kësaj duhet të paguajë edhe një tarifë shtesë administrative prej njëzet e pesë për qind (25%) për të mbuluar shpenzimet e transaksionit.

Neni 12 DOKUMENTACIONI DOGANOR I PRANUAR

12.1 Importi/eksporti tregtar

12.1.1 Për të plotësuar procedurat e import/eksportit UNMIK-u ka vënë në përdorim një Dokument Unik Doganor (DUD) dhe listën-Bis DUD në pajtim me ligjin ekzistues.

12.1.2 Dokumenti i sipërpërmendur mund të merret vetëm në Zyrën Doganore të UNMIK-ut në Prishtinë. Një komplet i Dokumentit Unik Doganor kushton 1.50 DM, një komplet i listave-Bis DUD kushton 1 DM.

12.1.3 Dokumenti Unik Doganor mban titullin “Unitet Nation Interim Administration Mission in Kosovo” (“Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë”). Asnjë dokument tjetër që mund të paraqitet si Dokument Unik Doganor nuk është i vlefshëm.

12.2 Mallrat e importuara në bagazhin e personave privat

12.2.1 Personat që udhëtojnë me autobusë apo me automjete private lejohen të importojnë pa doganë, akcizë apo tatim mbi shitjen mallra për përdorim personal në një vlerë maksimale deri në 200 DM. Personat që e tejkalojnë këtë shumë duhet të paguajnë doganën në pikat e kalimit kufitar akcizën dhe tatimin mbi shitjen,.

12.2.2 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut lëshon një mandatarkëtim ku specifikohet shuma e paguar e doganës, e akcizës dhe e tatimit mbi shitjen. Mandat/arkëtimi duhet të mbajë titullin “Unitet Nation Interim Administration Mission in Kosovo” (“Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë”). Asnjë mandatarkëtim tjetër nuk është i vlefshëm.

12.2.3 Mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi që paguan detyrimin tatimor si dhe nga nëpunësi që e mbledh detyrimin tatimor. Origjinali mbetet në bllokun e mandatarkëtimeve, një kopje i jepet personit që ka paguar detyrimin tatimor dhe një kopje tjetër përcillet në SDK bashkë me paratë.

Neni 13 VULAT ZYRTARE

Për qëllimet e zhdoganimit përdoren vetëm vulat zyrtare të lëshuara nga UNMIK-u. UNMIK-u duhet të lëshojë vulat zyrtare për përdorim nga BPK.

Neni 14 GJUHËT ZYRTARE

Dokumentet e doganës duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe serbe.

Neni 15 KUNDËRVAJTJET DOGANORE DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME TO

15.1 Rregulloret ekzistuese mbi kundërvajtjet doganore mbeten në fuqi. Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së UNMIK-ut nxjerr udhëzime për punonjësit e doganës në lidhje me kundërvajtjet doganore, të cilat përfshijnë rastet e mosparaqitjes së vërtetë të vlerës, fshehjes-mosdeklarimit të mallrave dhe mospërshkrimit real të mallrave.

15.2 Për ngarkesat e mallrave të refuzuara nga inspektorët fitosanitarë apo veterinarë, agjentit doganor-importuesit duhet t’i jepet një deklaratë me shkrim. Ngarkesa e mallrave të refuzuara nuk lejohet të hyjë në Kosovë dhe, në bazë të kërkesës së importuesit, ato shkatërrohen nën mbikëqyrjen e doganës. Shpenzimet për shkatërrimin i bart importuesi. Importuesit i kthehen të gjitha detyrimet doganore të parapaguara.

Neni 16 STATUSI PREFERENCIAL

Marrëveshja doganore ekzistuese me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për statusin preferencial mbetet në fuqi.

Neni 17 KUFIZIMET NË IMPORT

17.1 Kufizimet që aktualisht zbatohen për mallrat e importuara nga Sllovenia dhe Shqipëria pezullohen. Tarifa ekzistuese që përcaktohet në nenin 1 të kësaj Direktive Administrative mbetet në fuqi.

17.2 Importi, transporti, shpërndarja dhe shitja e nënprodukteve të naftës (nafta dhe lubrifikantët) për dhe në Kosovë janë subjekt i licencimit nga UNMIK-u.

Neni 18
TATIMET

Deri te një njoftim tjetër pezullohen të gjitha tatimet, me përjashtim të detyrimit doganor, akcizës dhe tatimit mbi shitjen të përmendura në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1993/3 të datës 31 gusht 1999.

Neni 19
ZBATIMI

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut herë pas here nxjerr udhëzime për zbatimin e kësaj direktive administrative.

Neni 20
LEGJISLACIONI NË FUQI

Dispozitat e ligjeve në fuqi në lidhje me detyrimet doganore, akcizat dhe tatimin mbi shitjen zbatohen në Kosovë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1993/3 të datës 31 gusht 1999 dhe dispozitat e neneve 1 deri 19 të mësipërm të kësaj direktive administrative.

Neni 21
ANEKSET

Anekset I, II dhe III të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1993/3 të datës 31 gusht 1999 i bashkangjiten këtij akti për lehtësi përdorimi.

Neni 22
HYRJA NE FUQI

Kjo direktivë administrative hyn në fuqi më 1 shtator 1999.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit tëPërgjithshëm

ANEKS I

LISTA E MALLRAVE Të PËRJASHTUARA NGA DETYRIMET DOGANORE

PËRSHKRIMI I MALLIT

Eksportet

Produkte farmaceutike

Instrumente dhe aparate mjekësore dhe kirurgjikale

Qumësht

Vajra dhe yndyrna

Perime

Fruta

Pulla postare dhe letra me vlerë

Mallra të importuara për UNMIK-un, UNHCR, ICRC, Kryqin
e Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe, OJQ-të e regjistruara në
Kombet e Bashkuara

Mallra të importuara për misionet diplomatike dhe konsullore për
përdorim zyrtar të tyre

ANEKS II

LISTA E MALLRAVE Që I NËNSHTROHEN AKCIZES

Përshkrimi i mallit Përqindja e akcizës

Gazolinë 50% të vlerës

Naftë për automjete 25% të vlerës

Prodhime të tjera të 5% të vlerës
përpunimit të duhanit

Pije freskuese 50% të vlerës

Kafe 15% të vlerës

Aparate video 15% të vlerës

ANEKS III

LISTA E MALLRAVE Të PËRJASHTUARA NGA TATIMI MBI SHITJEN

Eksportet

Produkte farmaceutike

Instrumente dhe aparate mjekësore dhe kirurgjikale

Qumësht

Vaj dhe yndyrna për gatim

Perime

Fruta

Pulla poste dhe letra me vlerë

Mallra të importuara nga UNMIK-u, UNHCR, ICRC, Kryqi i Kuq dhe Gjysmë Hëna e Kuqe, OJQ-të e regjistruara me Kombet e Bashkuara

Mallra të importuara nga misionet diplomatike dhe konsullore për përdorim zyrtar të tyre